



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 9/1011 Dt. 14 / 03 /2025

**Rregullore për Procedurat dhe Përgjegjësitë e akreditimit dhe Riakreditimit të Programeve
Studimore në UKZ**

Mars, 2025

Në bazë të neneve 42 dhe 48, të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, Senati i UKZ-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 10.03.2025, miraton këtë:

Rregullore për Procedurat dhe Përgjegjësitë e akreditimit dhe Riakreditimit të Programeve Studimore në UKZ

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për inicimin, hartimin, aprovimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve të studimit, si dhe përcaktimi i përgjegjësive të personelit akademik në raport me programet e studimit.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjiilan, njësitë akademike, stafi, studentët dhe të gjithë akterët e tjerë, të cilët bëjnë propozime për programe të reja studimi, si dhe për monitorimin, vlerësimin apo rishikimin e programeve aktuale.

Neni 3

Inicimi i programeve të reja

1. Propozimi për inicimin e programeve të reja mund të bëhet nga:

- 1.1. Menaxhmenti i universitetit;
- 1.2. Këshilli i njësisë akademike;
- 1.3. Komisioni i studimeve i njësisë akademike;
- 1.4. Trupat Këshillëdhënës;
- 1.5. Stafi akademik;
- 1.6. Anëtarët e Alumnit (ish-studentët e UKZ-së);
- 1.7. Studentët;
- 1.8. Akterët relevantë të jashtëm (bordi industrial, etj.).

Neni 4

Detyrat e propozuesve

1. Çdo propozues i paraparë në nenin 3 të kësaj rregulloreje, për inicimin e një programi të ri studimi, ka për detyrë që:
 - 1.1. Të hulumtojë tregun e punës;
 - 1.2. Të ketë takime me trupat këshillëdhënës dhe palët e tjera të interesit;
 - 1.3. Të bëjë analiza të ndryshme përmes pyetësorëve apo grupeve fokusuese;
 - 1.4. Të analizojë nëse ka programe të ngjashme që ofrohen në Kosovë;
 - 1.5. Të hulumtojë nëse programe të ngjashme ofrohen në universitetet relevante evropiane (krahasueshmëria).
2. Procedurat e lartpërmendura vlejnë edhe për programet që aplikohen për riakreditim.

Neni 5

Procedura e inicimit

1. Propozuesit e programit të ri të studimit, pas konsultimit me Komisionin e Studimeve të njësisë akademike, duhet t'i drejtohen Këshillit të njësisë akademike me një dokument përmbledhës të programit të propozuar, i cili përmban:
 - 1.1. Emërtimin e programit, nivelin, kreditët, specializimet (nëse ka), numrin e studentëve dhe kodin e zonës së subjektit Erasmus (ESAC);
 - 1.2. Qëllimin e programit;
 - 1.3. Misionin (programi i iniciuar duhet të jetë në harmoni me misionin e UKZ-së dhe të njësisë akademike dhe organizative përkatëse);
 - 1.4. Përmbajtjen e programit;
 - 1.5. Rezultatet e të nxënit (të paktën 7);
 - 1.6. Të sigurojë që ekzistojnë bartësit e kualifikuar të fushës përkatëse, të cilët plotësojnë kushtet sipas kërkesave të AKA-së.
2. Përpos pikave të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, propozuesit duhet t'i përmbahen formularit specifik, i cili është pjesë e manualit.
3. Propozuesi ka për obligim t'i bashkëngjisë dokumentit përmbledhës të cekur në pikën 1 të këtij neni dëshmi për çdo hulumtim, analizë apo takim të bërë, sipas paragrafit 1 të nenit 4 të kësaj rregulloreje.
4. Në rastet kur propozues është vetë Këshilli i njësisë akademike, atëherë Këshilli është i obliguar të formojë një komision për ndjekjen e procedurave të inicimit, sipas kësaj rregulloreje.
5. Në rastet e propozimeve për formimin e njësive të reja akademike, propozimet përkatëse, të shoqëruara me gjithë dokumentacionin sipas nenit 4 dhe paragrafit 1 të nenit 5, duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt Senatit të Universitetit nga propozuesit.

6. Iniciuesit duhet t'i dorëzojnë propozimet për programe të reja, më së largu 45 ditë para hapjes së afatit për aplikim në AKA.

Neni 6

Afati kohor për aprovim

1. Këshilli i njësisë akademike, pas pranimi të raportit për program të ri apo për program në riakreditim, jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, duhet ta shqyrtojë propozimin.
2. Këshilli i njësisë akademike, me vendim, mund ta refuzojë apo ta pranojë propozimin për program të ri apo për program në riakreditim.
3. Pas aprovimit nga Këshilli i njësisë akademike, propozimi për program të ri apo program në riakreditim shqyrtohet nga Menaxhmenti i UKZ-së, KMCV dhe Senati, i cili është organi i vetëm vendimmarrës për aprovimin apo jo të propozimit për programin e studimit.
4. Në rast të aprovimit, inicuesi, jo më larg se tre (3) ditë pune, duhet të procedojë në Komisionin e Studimeve në nivel të njësisë akademike, të cilët, së bashku me bartësit e programit të caktuar nga Këshilli i Njësisë, do ta hartojnë programin e studimit.

Neni 7

Udhëheqësit dhe bartësit e programit të propozuar për akreditim/riakreditim

1. Udhëheqësit e programeve studimore
 - 1.1. Udhëheqësi i programit studimor është Dekani i njësisë akademike. Në raste të veçanta, udhëheqësi i programit mund të caktohet njëri nga bartësit ose njëri nga mësimdhënësit e programit, me kontratë të rregullt në UKZ.
 - 1.2. Udhëheqësi i programit koordinon veprimet dhe hapat me bartësit e tjerë deri në realizimin e procesit të akreditimit/riakreditimit.
 - 1.3. Udhëheqësi i programit ka për obligim zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve, të marrë pjesë në hartimin e planit të veprimit, planit të zbatimit të rekomandimeve dhe dokumenteve të tjera strategjike për programin.
 - 1.4. Udhëheqësi i programit ka përgjegjësi që të zhvillojë kontakte me të gjitha palët për të garantuar suksesin e programit studimor.
2. Bartësit e programeve studimore
 - 2.1. Për të qenë bartës i një programi studimor, një pjesëtar i stafit akademik duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga normativat e UKZ-së, AKA-së dhe KSHC-së.
 - 2.2. Bartësit e programit propozohen nga propozuesi, ndërsa caktohen nga përgjegjësi direkt – Dekani, ose, në rastin e programeve të reja që funksionalizojnë njësi të re akademike, nga Rektori.
 - 2.3. Bartësi i programit duhet të jetë në koordinim të vazhdueshëm me përgjegjësin direkt/Dekanin për çdo çështje që mund të ndikojë në programin studimor.

- 2.4. Bartësi i programit duhet të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë sipas obligimeve të përcaktuara nga përgjegjësi direkt, respektivisht normat e UKZ-së.
- 2.5. Bartësi i programit, qoftë në proces akreditimi apo riakreditimi, nuk mund të ndërmarrë veprime të njëanshme, pasojat e të cilave mund të jenë të ndjeshme për programin ose institucionin, dhe të cilat janë të sanksionuara sipas normave ligjore në UKZ.
- 2.6. Asnjë veprim i pakoordinuar nuk mund të bëhet nga bartësit e programeve, dhe çdo veprim i pakoordinuar me përgjegjësin direkt të njësisë akademike është jashtë kompetencave të bartësit dhe sanksionohet përmes akteve në fuqi.
- 2.7. Bartësit kanë për obligim të sillen me përgjegjësi ndaj detyrimeve që dalin nga statusi i bartësit të programit, dhe çdo veprim që mund të shkaktojë pasiguri, shqetësim apo njolloshje të programit është i sanksionuar në bazë të normave ligjore në UKZ.
- 2.8. Nëse një profesor (bartës i caktuar apo bartës i programit), me veprim ose mosveprim, shkakton pasoja që lidhen me detyrat e bartësit të programit, pa përmbushur ndonjërin nga pikat e nenit 33, pika 4, të Rregullores (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, atëherë ai/ajo realizon shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi, të cilat përcaktohen nga Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë, si dhe Rregullorja (QRK) Nr. 11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publikë, Kodi Etik i UKZ-së dhe normat e tjera në fuqi.
- 2.9. Menaxhmenti i njësisë akademike, apo edhe i UKZ-së, mund të vendosë për emërim, tërheqje dhe zëvendësim të bartësit nga programi i caktuar, varësisht nga nevojat dhe përcaktimet strategjike, dhe bartësi i programit nuk ka asnjë të drejtë të refuzojë këtë vendim.

Neni 8

Hartimi i programeve (Raporti i vetëvlerësimit)

1. Përgjegjës për hartimin e programeve të studimit janë:
 2. Bartësit e programeve të studimit, dhe
 3. Grupi punues i formuar nga Këshilli i njësisë akademike.
2. Detyrat e bartësve të programit janë:
 - 2.1. Udheheqin me grupin punues për hartimin e programit;
 - 2.2. Analizojnë nevojat e tregut për programin në hartim;
 - 2.3. Marrin pjesë në hartimin e pritjeve mësimore (learning outcomes);
 - 2.4. Përcaktojnë raportin e lëndëve të obligueshme dhe zgjedhore në program;
 - 2.5. Hartojnë tabelarët me përmbajtje të programit sipas standardeve ECTS, të ndër lidhura me pritjet mësimore;
 - 2.6. Organizojnë mësimdhënësit potencialë që të hartojnë përmbajtjet e syllabuseve;
 - 2.7. Deri në ditën e vlerësimit nga ekspertët e jashtëm ndërkombëtar, bartësit e programit janë të obliguar të mbajnë simulime me grupe pjesëmarrëse që do të marrin pjesë në takimin me ekspertët.

3. Detyrat e grupit punues përcaktohen me vendim në momentin e themelimit.

Neni 9

Dokumentet për hartimin e programeve të studimit

1. Hartuesit e programit të studimit u përmbahen dokumenteve në fuqi, si në vijim:
 - 1.1. Statutit të UKZ-së;
 - 1.2. Rregullores për programet e studimit;
 - 1.3. Udhëzuesve për programet e studimit.
2. Dokumenteve të jashtme, si në vijim:
 - 2.1. Udhëzimi Administrativ (MASHT) 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (me të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e tij);
 - 2.2. Korniza Kombëtare e Kualifikimeve;
 - 2.3. Manuali i Agjencisë së Kosovës për Akreditim;
 - 2.4. Shablloni për hartimin e programeve (nga AKA);
 - 2.5. Dokumenteve të tjera të përcaktuara nga zyra përgjegjëse në UKZ, AKA, KSHC, apo ndonjë institucion tjetër relevant.
3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e akteve ligjore, nënligjore, manualeve, apo dokumenteve të tjera të nxjerra nga MASHT, AKA, UKZ, dhe që rregullojnë këtë fushë, bartësit e programit janë të obliguar t'i respektojnë siç janë parapare në këtë rregullore.

Neni 10

Aprovimi i programeve

1. Aprovimi i programeve të UKZ-së bëhet si më poshtë:
 - 1.1. Aprovimi i brendshëm (nga organet e UKZ-së);
 - 1.2. Aprovimi i jashtëm (nga Agjencia e Kosovës për Akreditim).

Neni 11

Aprovimi i brendshëm

1. Aprovimi i brendshëm duhet të kalojë përmes organeve të UKZ-së.
2. Programi i propozuar duhet të miratohet nga Këshilli i njësisë akademike, si faza e parë.
3. Pas miratimit nga Këshilli i njësisë akademike, njësia akademike duhet ta dërgojë të gjithë dosjen e programit për shqyrtim në Menaxhmentin e lartë të UKZ-së dhe në Këshillin për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim (KMCV), si faza e dytë.
4. Menaxhmenti, pas shqyrtimit të dosjes dhe përputhshmërisë së programit me strategjinë e UKZ-së, jep rekomandimet për miratim ose jo-miratim.
5. KMCV, pas analizimit dhe shqyrtimit të dosjes, i rekomandon Senatit të UKZ-së miratimin ose jo të atij programi.

6. Senati është organi i fundit vendimmarës për aprovim ose jo të programeve të studimit në aplikim, dhe kjo është faza e tretë dhe e fundit.
7. E gjithë procedura nga momenti i inicimit deri në aprovimin nga Senati i UKZ-së, duhet të përfundojë më së largu 15 ditë para mbylljes së aplikimit.

Neni 12

Aprovimi i jashtëm

1. Aprovimi i jashtëm i fazës së parë të programit në aplikim bëhet nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (faqja e parë, shtojcat, bartësit).
2. Pas aprovimit nga KSHC, AKA njofton UKZ-në nëse programi është aprovuar apo jo, dhe nga dita e pranimi të njoftimit, UKZ duhet të hartojë programin e studimit brenda 15 ditëve dhe ta dorëzojë në AKA.
3. Në rastet kur KSHC nuk aprovon programet në aplikim, UKZ ka të drejtë ankese sipas këshillës juridike të lejuar në vendim.

Neni 13

Monitorimi i zbatimit të programit të studimit

1. Përgjegjës për monitorimin e programeve të studimit janë:
 - 1.1. Koordinatorët/zyrtarët e cilësisë në NJA,
 - 1.2. Bartësit e programeve,
 - 1.3. Prodekani për çështje mësimore.
2. Monitorimi i programeve të studimit bëhet nga fillimi i vitit akademik në mënyrë të vazhdueshme.

Neni 14

Detyrat e përgjegjesve për monitorimin e programeve të studimit

1. Detyrat e përgjegjesve për monitorimin e programeve të studimit janë:
 - 1.1. Monitorimi i bartësve të programit dhe stafit akademik.
 - 1.2. Monitorimi i bartësit të lëndës, sipas planprogramit të akredituar.
 - 1.3. Monitorimi i orareve të ligjëratave dhe ushtrimeve.
 - 1.4. Monitorimi i implementimit të rekomandimeve të ekspertëve.
 - 1.5. Monitorimi i faqes web.
 - 1.6. Kontrollimi i planprogramit të programit sipas akreditimit nga KSHC.
 - 1.7. Monitorimi i vijueshmërisë së mësimi.
 - 1.8. Monitorimi i punës praktike.
2. I gjithë procesi i monitorimit të programit është paraparë në detaje në Udhëzuesin për programet e studimit, i cili është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 15

Vlerësimi i programeve të studimit

1. Vlerësimi i programit të studimit bëhet nga komisioni në nivel të NJA, i cili zgjedhet nga KMCV dhe vepron vetëm gjatë periudhës së kryerjes së vlerësimit të brendshëm të programit.
2. Komisioni ka si detyrë kryerjen e vlerësimit të programit dhe hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për programin e studimit. Komisioni ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.
3. Komisioni kryen vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të parapara në këtë rregullore dhe Udhëzuesin për Sigurimin e Cilesisë.
4. Vlerësimi i programit do të bëhet pas dy viteve, me kusht që gjatë monitorimit të mos ketë shqetësime ose probleme të identifikuara.

Neni 16

Instrumentet për vlerësim të programit

1. Komisionet për vlerësimin e programeve mund të realizojnë vlerësimin, pa u kufizuar, përmes instrumenteve të ndryshme, si në vijim:
 - 1.1. Pyetësorëve me studentë, alumni, punëdhënës, etj.
 - 1.2. Fokus grupeve për mbledhjen e mendimeve dhe sugjerimeve të detajuara.
 - 1.3. Analizimi i statistikave për fushat përkatëse të programit, duke përfshirë vlerësimet e tjera, si në vijim:
 - 1.3.1. Evidentimi i pjesëmarrjes së studentëve në ligjërata.
 - 1.3.2. Kalueshmëria e studentëve gjatë vitit akademik.
 - 1.3.3. Vlerësimi i syllabuseve për secilën lëndë.
 - 1.3.4. Regjistrimi i studentëve në raport me numrin e shpallur për aplikim dhe format e tjera, varësisht nga programi i vlerësuar.
 - 1.3.5. Vlerësimi i shpërndarjes së kredive nëpër lëndë.
 - 1.3.6. Vlerësimi i lëndëve mësimore dhe efikasiteti i materialeve të përdorura.
 - 1.3.7. Vlerësimi i elementeve të tjera të programit, si ligjërata, punime seminarike, praktika, projekte, laboratorë, etj.
 - 1.3.8. Vlerësimi i literaturës së përdorur, mungesave të identifikuara dhe masat për përmirësimin e situatës.
 - 1.3.9. Vlerësimi i implementimit të programit dhe planprogramit të studimit në vitin përkatës akademik.
 - 1.3.10. Vlerësimi i feedback-ut të marrë nga vlerësimi i bërë me studentë, punëdhënës, industri, etj.

Neni 17

Raportet e vlerësimit të programit

1. Komisioni, pas realizimit të vlerësimit të programit, do të hartojë raportin me gjetjet nga vlerësimi.
2. Raportin përfundimtar me rekomandime, komisioni duhet ta përcjellë në KMCV, përmes Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim.
3. KMCV, jo më vonë se 7 ditë pune pasi të jetë njoftuar nga zyra, do ta shqyrtojë raportin e pranuar nga komisioni. Në varësi të gjetjeve në vlerësim, do të japë rekomandime për përmirësim, rishikim, apo vazhdim të programit.
4. KMCV, raportin me rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet për përmirësim, ia përcjell Menaxhmentit të Lartë të Universitetit, Dekanit të Njesisë Akademike, Bartësve të Programit, Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, Zyrës për Mësimdhënie dhe Çështje Akademike, duke rekomanduar Rektorin për veprimet që duhet të ndërmerren.

Neni 18

Rishikimi i programeve të studimit

1. Rishikimi i programeve të studimit në UKZ bëhet çdo dy apo në katër vite, para periudhës së aplikimit për riakreditim.
2. Rishikimi i programeve mund të iniciohet me propozim nga:
 - 2.1. Komisioni pas vlerësimit të programit të studimit;
 - 2.2. KMCV.
3. Akterët që mund të propozojnë KMCV-së formimin e komisioneve për vlerësim dhe që shpjen deri te rishikimi i programeve të studimit janë:
 - 3.1. Rektori i UKZ-së;
 - 3.2. Senati i Universitetit;
 - 3.3. Udheheqësi i programit të studimit;
 - 3.4. Dekani i njesisë akademike përkatëse;
 - 3.5. Këshilli i njesisë akademike.

Neni 19

1. Në rast se komisioni, pas vlerësimit të programit, ka konstatuar se një program i caktuar ka pasur ngecje ose është evidentuar se duhet të ketë përmirësime, KMCV njofton Dekanin e njesisë akademike përkatëse. Dekani, përmes Këshillit të njesisë akademike, formon grupin punues për rishikimin e programit. Grupi punues përbëhet nga:
 - Bartësit e programit;
 - Komisioni i studimeve në nivel të njesisë akademike;
 - Studentët;
 - Aktori të jashtëm, si punëdhënës dhe ekspertë të fushës.

2. Grupi punues do të rishikojë, përveç fushave të rekomanduara për rishikim nga komisioni, edhe:

2.1. Misionin dhe objektivat e programit;

2.2. Menaxhimin e cilësisë, bazuar në rezultatet nga pyetësorët;

2.3. Stafin akademik të programit;

2.4. Përmbajtjen e procesit arsimor;

2.5. Pjesëmarrjen dhe suksesin e studentëve;

2.6. Hulumtimin dhe aktivitete kërkimore;

2.7. Infrastruktura dhe burimet për mbështetje të programit;

2.8. Rekomandimet e dhëna nga ekspertët e jashtëm të Agjencisë për Akreditim të Kosovës (AKA).

3. Sipas Manualit të AKA-së, gjatë periudhës së akreditimit të një programi, universiteti mund të bëjë ndryshime në programin e studimit brenda kufirit prej 20%. Ndryshimet që tejkalojnë këtë përqindje konsiderohen si krijim i një programi të ri dhe për këtë arsye, kërkohet që programi të kalojë një procedurë të re akreditimi. Ky proces rishikimi dhe përmirësimi është kyç për përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe për ruajtjen e vlerës dhe akreditimit të programeve të studimit në UKZ.

Neni 20


1. Grupi punues për rishikimin e programit duhet të respektojë standardet akademike sipas Manualit për Akreditim, Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutit të Universitetit dhe dokumenteve të tjera relevante.
2. Grupi punues, brenda një afati prej 30 ditësh, duhet ta dorëzojë programin e rishikuar dhe të përmirësuar në Këshillin e njësive akademike.
3. Këshilli i njësive akademike, pas aprovimit, e përcjell programin e rishikuar në KMCV, ndërsa pas shqyrtimit, KMCV e dërgon për miratim në Senat.

Neni 21

1. Të gjitha afatet e përcaktuara në këtë rregullore janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, në rast të ndryshimeve eventuale, të gjithë aktorët janë të detyruar t'i zbatojnë afatet e reja.
2. Pjesë e veçantë e kësaj rregulloreje është Udhëzuesi për Programe të Studimit.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit.



Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor

Kryesues i Senatit